Bedri Halimi

KËNGA E LUMIT



Bedri Halimi
KËNGA E LUMIT

Ekskluzivisht për
www.sa-kra.ch
dhe
www.syri3.com

Redaktor: Besim Zymberi

Recenzent: Merxhan Avdyli

Ballina: Sabir Krasniqi
Pikturat në brendi dhe mbrapina e librit: Bajram Gërdellaj

Bedri Halimi

KËNGA E LUMIT

Botues
Shoqata Kulturore "Ymer Prizreni"
Sharr 2009



HAXHI YMER PRIZRENI

YMER PRIZRENI

1

Vjeshtë e moçme ishte atëherë
Kur u zunë rrugët
Fushat filluan të na i errësojnë
Me pellgje gjaku
E qentë nuhasnin si statuja pa krah
Nuk kishin mall për Shqipëri e as për shqiptarë
As kujtesa nuk u punonte
Në tokë të huaj vdiqën turistë

2

Eh Ymer Prizreni
Dirigjent i Orkestrës së Vjetër
Pasardhës i rojeve të Kështjellës
Ti mendoje për tokën, për detin
Që të ketë buzëqeshje njerëzore
Nuk mbaje fjalim nga zyrat e fildishta
Me Ty larg dëgjohej
Kënga e ushtarit të vjetër
Dhe luhej për mrekulli vallja shqiptare

3

Ymer Prizren, poemë e pambaruar kurrë
Është e dhembshme, shumë e dhembshme
Kur ke frikë t'i afrohesh detit
E Ti je deti vetë
Që me dallgët tua luftoje trishtimin me stuhi
Për të ardhur te Ti
Ti thua se mund të vijnë
Vetëm ata që besojnë se drita nuk vritet
S'ia vlen, s'ia vlen jo të nisen tek unë
Ata që lirinë e pandehin si një lavire
As ata që e kanë humbur udhën në oborr
As ata që nuk duan ta shohin diellin
Askush shpresën s'ka arritur ta vrasë
As Ty o Ymer Prizreni
Ti je vetë shpresa që s'vdes kurrë

4

Ku janë Kainët?
Ku i kanë shtretërit?
As varre s'do të ketë për ta
Se varri është në Tokë
E Toka është e shenjtë or tungjatjeta
Prandaj mos harxhoni kot asnjë grusht dhe
Për ata që ecin me arkivol në shpinë

5

Përse mendohesh o Ymer Prizreni
Buzëqesh he burrë
Se rrufeja çan dhe shkëmbin
Por kurrë Kalanë e Vjetër
Ti do të vish!
Do të vish se s'bën!
Po s'erdhe,
As zogjtë e detit nuk do të fluturojnë
Në hapësirën e kaltër

6

Kam mall për Ty o Ymer Prizreni
Si s'të desha pak më shumë
Po Ti do të na durosh patjetër mëngjeseve
Është dashuria për tokën
Që të shtyn ta bësh këtë, Ymer
Tingujt e jetës marrin frymë me emrin tënd
Vrasësit e ëndrrave të bardha kanë frikë
Nga Ti - statujë e lirisë
Dhe gatuajnë tragjedi të reja
E nganjëherë na kafshojnë
Duke dashur të na puthin

7

Ujqërit e vjetër janë të pakapshëm përsëri
Rrinë gati me tehun e shpatës në dorë
Po ti Ymer, e doje fort Shqipërinë he burrë
Por jo pa Kosovën
Ti edhe sot troket në zemrën e njerëzve
Ti i urren prometejt e rrejshëm
Përse Ymer Prizreni jemi atdhe i mërzisë

8

Ku është vatani - jepni çdo gjë për të
Atëherë çdo pikëllim do të rëndojë lirë
Edhe mbi supet e kohës sime
Sot hyjnë e dalin njerëzit në atdheun pa atdhe
E nga pak ankohen në Ju
Që s'ua sollët parajsën në këtë botë
Kanë brengë në shpirt
Prandaj presin si qentë e braktisur
O Ymer Prizreni

9

Edhe sot në kohë ka lypës kohe
Përpjekja për ta është diç e kotë
Edhe ndihmës të zotit ka sot
Me gur të shenjtë që ligjërojnë si ujku plak
Por, celulat lëvizin
Pa lëvizje s'do kishte jetë
Ani pse lypsarët rebelohen me pagjumësinë
Ata duan rosa
Për zotin rosa
Ama të majme
Kufomat kërkojnë botë tjetër
Pa plazhe me gjëra të dobishme
Të bëjnë shaka me identitetin
Për ta zgjatur natën
Mbajnë fijen e shkrepëses në dorë
As mërziten për vitet e djegura

10

Dhe Pelegrinët presin diçka t'u sjellë fat
Nga idhujt e rremë
Trishtohen nga hija që i ndjek pas
Ymer burri
I vetmuari i largët
Njeriu e koha nuk do të lënë gërmadhë
Shpirti yt do t'ua presë ëndrrat njerëzve pa pendim
Malli për Ty nuk është vetëm Dhjetë Qershori
Dashuria pas ndarjes harrohet vetëm nga ndjekësit e dashurisë
E sofra e historisë i shënon të gjitha o Ymer Atdheu
Emri Yt i thur himn flamurit
Me një gur e një trung
Të mos mërdhihen zogjtë dimrit
Emri yt – kujtesë atdheu me plisa të bardhë
Emri yt – psalm për tokën në çdo kohë
Emri yt – zgjim nga gjumi i fundvjeshtës

11

Do të nisemi udhës sate
Me këngën e Lumit në gojë
Frymëmarrje të lirë
Të kenë edhe rrudhat gjatë dimrit
Kemi nostalgji për ty Ymer
Që hyre në mbretërinë e amshimit
E ne s'harrojmë të të kujtojmë
Sidomos para shkreptimës
Kur përrenjtë fillojnë të thahen
Me emrin tënd në luftë çdo gjë gumëzhin
Se në gjumë as të qarat nuk kanë kuptim

12

Kujdes me fjalën e dëshpëruar thua Ti
Bukuri e ftohtë pa kallinj është ajo
Dijeni se bereqeti i saj është dëshpërimi
Mbrëmë dikush tha se të rënët
Janë këngët e lirisë
Pylli nuk rrallohet po t'i presësh lisin
Në luftë trimi tregon trimërinë
Pas lufte trimëri tregon vetëm frikacaku
Ruhuni nga kundërshtarët e mi
Nga tregtarët e flamujve
Nga kombëtarët që lindin pas luftës
E kur të jeni të mërzitur shumë
Mos harroni ndërtojeni Piramidën
Do të vij t'u ndihmoj dhe unë



NAIL HYSENI - DANA

BALADË E PAKRYER

1
Nuk dua të rritet bari mbi çatinë time
As Zogu i zi në vend të përshëndetjes
Të këndojë elegji për shkëmbin e Kosovës
Pas heshtjes së gjatë
Kambanat e Eshref Krushës
Mallkuan anatemat
Që shkruan epitafin për idhuj të rrejshëm
O Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi
Bisha e zezë kërkon të na vërë në gjumë
Mbi zjarrin e fjetur

2
Nekrolog do të shkruajmë mik
Për ata që nuk e shohin diellin
Korbat duan të bëjnë udhë sërish
Me ndihmën e magjisë së papagajve
Jepni një minutë heshtje për Qytetin pa Qiell
Me imazh të pushkatuar
Nga strajca e krahut në shpinë

3
Më ka marrë malli për Ymer Prizrenin e Nail Hysenin
Tek i numërojnë varret në Brrut, Rapçë e Restelicë
Bresanë, Vraniq, Glloboçicë...
Gora e Opoja zonë e zezë në bisht të Ballkanit

4
E njoh Nail Hysenin, Mulla Rasim Zapodin, Eshref Krushën
Përmes Tokës, Gjakut e Diellit
Ata që ikën, nuk mund ta merrnin këtë gur me vete
Hej është ky gur i kësaj toke
Është ky plis - dëshmi e kësaj koke
Është plisi i Eshref Krushës, Ymer Prizrenit, Rasim Zapodit
I Haxhi Ymer Lutfi Paçarizit
Për Zotin edhe i Nail Danës
Dëshmi e rrënjës së gurit

5
Nuk dua ta shoh këngën e ngrysur o Qemal Mataj
Tek i këndon kobures së Ramadanit
As dritaren mos e le hapur kur fryn shtrëngata
Bjeshkët e shkreta ma kujtojnë vdekjen e peshës sime
Hija e kësulës së bardhë të mos shëtit pa mua
Rrënja e gurit u kërkon
Ymer Prizreni nuk ju ka harruar
Edhe Hasan Prishtina, Isë Boletini, Azem Bejta e Idriz Seferi
U bëjnë të fala:

6
Shumë ujq kanë udhëtuar këtejpari o Eshref Krusha
Lojën e vdekjes e vallëzonin o Nail Hyseni
Edhe Satanai kaloi këtejpari o Rasim Zapodi
Xhiroi film sekret me këngët e këtij trualli
Në mesnatë klithi nga vdekja e zakonshme
Dhe dridhej me Fundin e Lojës
Thuaja këngës Ymer Prizreni
Këngën vençe të mos na dëgjojë harrimi
Se Nail Dana me maliherin në dorë
Rrënoi përmendoren e turpit

7
Uji i tokës sime rrjedh
Rrjedh e nuk vë myk
Në ëndrrën e qeleshes së bardhë
Dikush sikur po e do vetminë
Hijen e plagës mbi kokë ende nuk e ka shëruar
Ja ka vjedhur flakën harrimit
Me ujin e madh të shtrëngatave
Do të vërë shenjen e dallimit

8
E Unë jam nisur me Nail Hysenin
Ta takojmë Ymer Prizrenin
Të takojmë edhe ndonjë njeri
Që kërkon ndjesë pse doli nga Rrethi

9
Kur rrjedh gjaku varre lihen mbrapa mik
E themelet e shtëpive të djegura
Këndojnë luţje pa klithmë
Për të pagjumët e këtij nënqielli

10
Ata që flasin shumë - s'thonë asgjë
Kanë mbetur shpuzë e bardhë në kortezh të zi
Pikëllimi ua djeg gjelbërimin
Në telat e sharkisë
Lë gjurmët e emrit tim e Nail Hysenit
Që gjeti diagnozën e legjendës në pyll

11
Keni porosi të bëjmë roje?!
Gjelbërimin, Ajrin dhe Ujin të mos na i ndotin
Për Koncertin e Lojës së Zezë
Emri juaj brohorit:
Dënon mëkatet e marsheve lakmitare
Të mos lejojmë të digjet Drita
Në zjarrin e Kronikës së Zezë

12
Edhe kur të bjerë Shi
Gjaku, Toka e Qielli ma ruajnë
Emrin, nderin, fisin e plisin

KËNGA E LUMIT

(Dëshmorëve të kombit nga Opoja)

Në vend të prologut

1.
Në varrimin e dëshmorëve
Kam bredhur pas krimit
Ditë shtatori ishte mik
Pikëllimi mbuloi fushën e tharë
Nga lëndina e lotëve
Vargu ngulmon
Për udhëtimin përfundimtar

2.
S`kam ardhur të hesht
Dua ta them shkoqur kush jam
I di letrat e hapura
Edhe fjalët nga përrallat
Të çmendurit s`duan dialog me vdekjen
Mos i lini kokat e nxehura
Pas furtunës të marrin erë
Këngën e lumit mos e ndal mik
Pa kitarë këndon baladë për vete
E unë shkruaj në qytetin e përgjumur
Për të pagjumët e maleve

3.
Po mik
Na duhen edhe krijesat e fushave
Edhe plaku që numëron yjet deri në agim
Insektet thurin ëndrra
Kur të vjen pranvera
Natën do t`i numërojnë yjet
Dhe çuditen kur liria s`i beson njeriut
Me të katërtat ecin serioz

4.
Engjëjt kthehen për t`u rrëfyer heronjve
Ju s`keni vdekur as dje as sot
E njeriu i pikëlluar
S`mund ta thoshte asnjë fjalë
Për pranverën që do të vijë
Elegji do të thurim o mik
Për të vdekurit që heshtën
Ninulla do t`u këndojmë
Fëmijëve të rritur me vonesë

5.
Opojë e çuditshme e dashura Opojë
Për pak biografi
Fëmijët të vështrojnë në sy
Për çaste lumturie
Vënë kokën në rrezik
Të varfrit thurin ninulla
Duke i qarë në vetmi

6.
Opojë ke besim të madh
Për pastrim të emrit
Hero anonim nuk ke
Sa për ta kaluar vdekjen
Askush s`është vetëm
Ndarja braktis takimin
Dëshiron heqjen e pluhurit
Dhe gjakun në dritare
Heronjtë në heshtje
Nga kulla të rrënuara
I këndojnë himn rinisë
Tregojnë rrugën e historisë
Për të ndershmit
Që ta kuptojnë të paktën njëherë
Të gënjyerit e përjetshëm

7.
Ah zogjtë
Kur të vijnë sërish
Për ta sjellë pranverën
Ditëlindjen e rinisë do e festojnë
Këto janë gjëra që s`harrohen mik
Figura të përjetësuara
Trëndafila të agimit
Do bëjnë roje
Të mos bëjë ftohtë trotuareve
Te gjoksi t`ua vënë
Nëntë të dashuruarve

8.
Kthimi te Ju
Është mjeshtri e çuditshme
Liria në heshtje
Elegji këndon për Ju
Paqja në kohë shiu
Mbet këngë pa emër
Pa melodi, pa tekst

9.
E Ju
Opojës nganjëherë
I thoni "mjaft urrejtje"
Të fshehta, të fshehta
I kanë valët e djepit
Jetimët e urrejtjes
Dimër i pikëlluar mbeten
Pa e kuptuar se nesër
Nuk do të jenë në udhë
Po nuk erdhën sot në vete.



ALAJDIN XHEZAIRI

ALAJDIN XHEZAIRI

1.
Me emrin tënd
U këndua himni i lirisë
Ëndërrim dhe ninullë
U bë legjenda e lashtë
Në mesditë duke pritur barbarët
Në qytet u bë qëndisja e Shamisë
E Qirinjtë ndriçojnë muret
Kur bilbilat këndojnë këngët e lirisë

2.
Për Alajdinin mos qani
Fatalistët u bënë skllevër të panënshtruar
Kudo që shkoj Alajdin
Do i them dy fjalë për verën
Dhe mëngjeset e bukura të vjeshtës
Pa ty nuk do të arrija të këndoja për lirinë
E unë me ty do të dal të shëtis
Me shokët e rënë
Mos më prek tha ushtari i panjohur
E keni harruar ëndrrën e erës

3.
Do të shkruaj letër Alajdin
Ku shihet rrezja e diellit në pasqyrë
Pastaj do fle pak
Dhe në mëngjes
Nga horizonti i lashtë
Do thurim elegji për luftëtarin e ri

4.
Elementi më i pistë i krijesës
Mbeti Kasollja e Zezë
Që u ndërtua duke pirë diellin
Mbi turpin e verës

5.
Eh Alajdin
Sa shumë kam dashur
Të këndoj në oborrin e të dëshpëruarve
Njeriu po digjet
Me kujtimet përtej kohës
Me emrin tënd Alajdin
Do të mbahet festivali i luleve
Ku do të ketë lutje për plagën time
Vjedhësit e pritjes
Nuk i thurin apologji nënshtrimit

6.
Alajdin
Dikush po i zhduk pa gjurmë gjërat piktoreske
Bukurinë e pyllit dhe gjuhën amtare
Alajdin
Ti mbete kositës në breg të detit

7.
Mos më pyet për vuajtjen e ëndrrave
Klithmë e mbytur mbeti gënjeshtra
Në tokën e zezë qyteti fle
E Ushtarët ëndërrojnë syhapur
Harruan këngën e gurëthyesve
Lamtumirë zemërim – i dhamë besë njëri-tjetrit
E kalorësi i erës pranverore
lutej për gurin e dëborës

8.
Alajdin
Pëllumbat e lirisë mbetën poemë e qytetit
Të përkujtojnë ty dhe tërë qenien tënde
Dhe unë besoj në ty – si bleta në lule

Nëse e kam këtë fat që të biedeshmor,ju lutemi ,mi varrosni eshtrat në vendlindje se vetem ay i qetë do të pushoj. e nëse do te jem i gjall do të pres në fshat me flamur..... (A.G)

ABDURRAHMAN GËRDELLAJ

ABDURRAHMAN GËRDELLAJ

1.
Kur lisat po i rrëzoheshin pyllit
Në zemrën e tij hyre pa bubullimë
Festën e largët e ktheve në ditëlindje
Pa heshtje pranove thirrjen
Flake tymin e cigares dhe bërtite
Sa e bukur je o tokë e vendit tim
Padrejtësitë do t'i zhbëjmë me lavdinë tonë
Vajin e nënave e ndalet
Me dashurinë për tokën
Pa alternativë - ia hoqët thonjtë mërzisë

2.
Erdhe si fluturat në Atelie
Me fener në dorë
Po Abdurrahman
Qyteti pa qiell të mos mbetej fillikat
Lutjet e nënës të mos kishin pendesë
Rrugën ia hape pranverës në çdo fshat

3.
As shiu, bora e as e diela nuk të ndali
Deklaratave të rreme nuk u besoje
Në kujtesën e amshimit hyre përgjithmonë
E sot kush jemi ne para teje
Dikush dëfrehet pa lëvizje shatërvanëve
Këngën e territ ende kujtojmë
Të shkruar me shpallje mbi një teh

4.
Valixhet dhe kujtimi i largët
Mbeten breg kujtimesh e përrua harrimi
Atë pasdite të ëmbël
Shave pemët e pagjumësisë
Dhe bëre shaka me vdekjen
Dhe porosite:
Nuk mjafton të vdesësh
Me kujtesë të pamëshirshme
Për botën e blertë
Ja vlen të eci kah dielli

5.
Me sy të ndritshëm nëse ti s'do ishe
Do të mbeteshim në kujtesë të pamëshirshme
Mëngjeseve mallkove lumenjtë e kotësisë
Krijesat e një nate tjetër
Që kishin humbur gjithçka
U hape dritaren e jetës
E ti Abdurrahman
Edhe sot thua
Mos bërtisni në shenjë kujtimi
Me gjakun tim le të vdes vajtimi juaj
Në kohë dhe histori
Gjaku im nuk ua kërkon të pamundurën
Nëse koha u rrëmben
Qielli do mbetet vetëm

6.
Nga pullazet hyn ajri i barit
Asgjë nuk ka humbur në ditën e sëmurë
Ndjeu dhembje për gjerat që s'i njohim
Vendstrehim i bëre zogjve të paqes

7.
Abdurrahman
Askush s'të harron o njeri i kohës sime
Netëve të dimrit kërkoje lutje për shiun
Se jeta është kujtim i një zgjimi
Për ty – udhëtar i pagjumë
Që kurrë vdekja s'do të vijë në sytë e tu

ADEM BERISHA

ADEM BERISHA

1.
Po, zemra jote pandërprerë rrihte
Për këngën e Kosovës
Në vjeshtën e sëmurë tregove burrërinë
Shpërfille vdekjen
Ringjalle shpresën
Dhurove vetveten
Që t'i ruanim shekujt

2.
Adem
Sot vdiq armiku im
Me duar të trishta vdiq
Në duart e Evropës
Pika shiu me lëvizje ranë
Me gjuhë flake bëjnë të vuajnë
Egërsirat në banesën e rrethuar
Që në pritje kundërmojnë

3.
Adem Berisha
Ti je qenie që ecën
E tanishmja drithërohet me ty
Sa herë bie shi
Atmosferë ëndrre krijon mbi gjethet e pemëve
Dielli perëndoi në sheshin e bardhë
Kambanat përcollën këngën e harkut për blloqet e bardha

4.
Ti ishe një pëllumb i burgosur
Që vrave ëndrrën e Pemës vrastare
Adem, ti e puthe perspektiven e zemrës së shqyer
Që jashtë mase udhëtonte pafund
Ti nuk je ngjarje e papritur
Që rri pas derës së kyçur
Emri yt rikujtim – roje në Agim
Dritë pa hije mbete - Fytyrë e paqes
I papërgjysmuar këndon ninullë në kalanë e përjetshme
Emri yt vajtim i madh për errësirën
Me emrin tënd edhe nata ndriçon natën
Të mos vë rrudha dielli
Në vështrim të hyjnive
Të këndohet elegji buzë detit

5.
Po ti më gjete Adem
Në të gjitha dyert sot më ke
Pa ardhur mëngjesi
Mos e kthe kokën në horizont
Përmes kohës e hapësirës
Mbajmë duart e bashkuara
Nuk dua të fle thua ti
Kur bie zilja
Autoportret i bëj zbrazëtisë së vdekjes
Në zjarr e hi

6.
Ardhmëria vjen si flutura
Në dritën e qiriut tënd
Këngë për qiellin të këndoj
Ta varros murtajën
Në flakën e natës së heshtur

7.
E unë të dua
Sepse e munde vdekjen
Duke u bë engjëll mbrojtës
O njeri i madh i stinës së bukur



"Baba Sylë të ma bëni hallal ti dhe baba Lokë,dhe te ma japish fjalen që nuk do të qashë,se u plotësuan deshirat e mia,u bëra ushtar.Ju bën të fala fëmijëve,po shkoj te Adem Jashari" (F.S)

FETAH SYLEJMANI

FETAH SYLEJMANI

1.
Ti ishe orë e së vërtetës
Dilemën e shndërrove në realitet
Ua solle lumturinë dorështrënguarve
Në lutjet e mesditës
Kukuvajkat bënin kryqëzim rrugësh
E stinën e kalbëzimit e ëndërronin

2.
Fetah
Pasqyrë e historisë për llojin njerëzor
Koha kalon
Kurse ti sonte shkruan kronikë
Për njerëzit e shtangur
Ti i thirre të nisemi
Të mos t'u themi faleminderit xhelatëve
Nga lartësia e maleve
Thirre thnegla të palodhshme
Të hynin në realitetin tënd

3.
Fetah
Emri yt të tregoi
Se si e vërteta të bënë të lirë
Të mos mashtrohemi pas parasë së egër
Si meteor u shndërrove në pranverë
Diku brenda teje prangose përgjithmonë
Fytyrën e përbindëshit

4.
Dhe sot flasim Fetah
Për botën e dashurisë
Se si jeta është e bukur
Po kjo s'mund të bekojë asgjë
Pa këngën tënde lamtumirëse
Unë nuk jam i shkathtë të flas me ju
Por e nesërmja erdhi
Sot në mëngjes
Nga gjaku juaj – në sytë tanë

5.
Nuk është e çuditshme – thua?
Pa vajtim, pa zhurmë
Sa është ora?
Ti i tregove historinë e ëndrrave të rrezikshme
Toka e fshehtë përherë do të ëndërrojë për ty Fetah
Dhe ne s'kemi arsye tjetër
Vdekja vjen një ditë
Dhe shkruan marrëzinë në histori

6.
Po Fetah
Nganjëherë prapë shihemi
Pa lajme dredhake
E dikush vjedh vezë
Dikush ëndërron pse s'shkon në Paris
E dikush numëron ende të pushkatuarit
Ikja është e thjeshtë Fetah
Përjetësia e vështirë

7.
Satanai vdiq nga kanceri në shtyllën kurrizore
Kish arsye të fortë të mos i bënte ballë dimrit
Elegjia e vetmisë dhe mosmirënjohja
U varrosën me duart tua
Si një zë tjetër dëgjohen
Kështu do të ecim me këngën e emrit tënd
Çdo rrebesh do të përballohet

8.
Fetah vëllai
Kush nuk të njeh ty mëngjeseve të errëta
Me afërsi murmurime
Çdo fjalë e jotja është dritë
Çdo shkronjë e emrit tënd është shpresë
Pak rëndësi ka mospërfillja për ty
Për ata që shohin nga dritaret e zeza
Ata kanë nevojë ende
Për ushtrime shpirtërore – për ta parë pemën e bardhë

9.
Midis detit që nuk zbulohet kurrë
Duke parë buzëqeshjen tënde
Ne shkruajmë përralla për stinët e jetës

FISNIK IBRAHIMI

FISNIK IBRAHIMI

1.
Fisnik, me emër të bardhë
Kur plakja të vijw për të gjithë
Ti për herë i ri
Shumëkush pret vdekjen
Ti përherë i pavdekshëm
Dje Karroca e kuqe u zhgënjye
Tani Shtëpiakja e re
Zgjohet lirshëm në kullën e moçme

2.
Po Fisnik valltari
Na përshëndet nga kopshti
Me ligjërim zjarri
E kumbim e bubullimë
Ç'fat ke përjetuar, kur dhe pse?
Fatin e zgjimit të përjetshëm
Ne të thirrurit nga ti
Në zanatin e ëndrrës së vjetër
Për të respektuar vlerat e kësaj bote

3.
E ti
Nga qielli i numëron kafshët e zeza
Ligjërim i bën malit
Për këngën e amshuar
Këtu ata përsëri duan muzikë uji
Të rriten lulet e kësaj toke

4.
Në çdo udhëtim
Qyteti të mos humb pranverën
Soji i egërsirave – do të përshkojë natën
Të krijojë tragjedi të re
Po gjaku yt nuk lejon hije në dritë
Dhe pemët e dimrit i mbajnë gjerat si janë
E Satanai i padukshëm
Kot shpresoi kthimin
Nuk do ta presim me lodra druri

5.
Fisnik
Hapat e tu dëgjohen sërish
Sa herë të fryjë stuhia
Sa herë të këndojë qyqja
E zogjtë nëpër pyje
Këndojnë për ty Fisnik
Shpresa e gënjeshtrës të mos zë rrënjë
Të mos lejojnë të fiket drita
Të mos mbetet vetëm fyelli në lëndinë

6.
O Fisnik
Emri yt nuk lejon të na përqesh pema e helmit
Është më bujare kjo tokë
Kur ka gjakun tënd brenda
Kur s'ka liri
Kambanat e vdekjes
Thërrasin për ndryshueshmëri
Të mos na fiket drita
Zemra të hidhet për gjendje tjetër
E Grabitësit e ëndrrave përjetësisht
Thurin ode për vetminë

7.
Ju jeni lule, të maleve, fushave
Ku bleta thith nektar
Me gjakun tënd – vrave poshtërsinë
Dhe fluturove lart maleve
Ta qetësosh etjen e ëndrrave tona pranverore

8.
Fisi, pa lamtumirë i ke dashur muzgjet tona
Lypsarët i ktheve në shtëpi
Të luten të dielave – me vajin e ekskavatorit
Pa ty
Asnjë mbrëmje nuk do të ishte si të tjerat



ILMI BAHTJARI

ILMI BAHTJARI

1.
Kur himni këndohej për kohën që kish ikur
Brodhe shumë rrugë për ta mbyllur të shkuarën jetëshkurtër
Për ta sjellë të ardhmen e përjetshme
Pikëllimi për të vrarët
Ti la të hapura portat
Dhe u nise për t'u kthyer në përjetësi
Me udhëtimin përfundimtar

2.
Po ti Ilmi kishe ardhur të këndoje me maliher
Jo të tregoje përralla – as dialog me vdekjen
Për ata që të mos harrojnë këngët kalorësiake
E sot qyteti pa gjumë nuk mbeti pa gjurmë
Shkruan për bijtë e maleve
Për lindjen e krijesave në agim
Për rrugëtarët e pandalshëm
Për pleqtë e diellit që numërojnë yjet

3.
Sa shumë
Sa shumë yje u bëtë Ilmi
Në pranverën që e sollët
Ti je vetë liria – që beson te njeriu
Ju nuk jeni – vdekja – po njeri që ecën serioz
Kështu the Ilmi apo jo
Për zhurmën e pikëlluar – nuk thoshe asnjë fjalë
I besoje ardhjes së pranverës
E jo të vdekurve që heshtin çdo ditë

4.
Ilmi Bahjtjari burrë i çuditshëm mbete
Fëmijët ende të vështrojnë në sy për çaste lumturie
Ti e di të vërtetën e gjelbërimit
E di edhe ninullën e ujit, mjegullës
Por emrin s'ia thua
As ninullës së të varfrit
Dhe bëre emër të madh
E ardhmja të mos plaket

5.
Ilmi Bajhjari ti nuk je hero anonim
Sa herë kalon këndej vdekja
Zemra jote është në çdo oborr
Një minutë heshtje është shou satirik për ju
Kujtimi për bukën e zezë e sende të vogla
Janë mësime që vijnë nga ti
Ju jeni dëshmi se askush nuk është vetëm
Kur gjërat me vlerë si mbulon pluhuri i harresës
E sot takohemi sërish
Pa bastisje – as gjak në dritare
Se ti je – trëndafili i domosdoshëm

6.
Çdo vit që kalon – ne plakemi
E ti nuk ndryshon
Për herë i këndon himn rinisë me emrin tënd
Të ndershmit e përjetshëm t'i ndreqin gabimet
Duke përshëndetur zogjtë e amshimit
Gjaku yt – himn – për fillim pranvere
Gjëra që sharrohen – janë zbulime të thjeshtësisë
Liria e gjakut tënd mjeshtri e çuditshme mbeti
Djep i kaltërsive të paqes
Prandaj Ilmi Burri ti nuk je këngë pa emër
Këndon ode për urrejtjen
Të mos ketë kthim në heshtjen mashtruese
Edhe jetimët e urrejtjes – të mos banojnë te ti

7.
Pak gjëra duhet ditur për ta kuptuar emrin tënd
Për veten tonë
Ata që s'të kanë parë në rrugë
Të presin – të vish sonte
T'ua heqësh dimrin e pikëlluar nga shpirti
Se ti përsëri je në udhë, përsëri udhëtar



"Ademi na mësoi se si të vdiset për atdhe " (R.B)

RUZHDI BERISHA

RUZHDI BERISHA

1.
Atëherë kur qetësia përhapte zbrazëtinë
Ti bëje thirrje se çdo gjë është e imja
Nuk dije të shkruaje pa arsye
Çdo gjë e rrejshme – është mashtrim prof. Ruzhdi
Ëndërroje me ankth të kaluarën dhe të tashmen
Meditoje për nesër mbrëma
Zinxhirët e vdekjes ishin vetëm hije e vjeshtës së sëmurë
Ndarja me ty pikëllim i një ylli
Që të ndërrohej vjeshta e sëmurë

2.
Ruzhdi burri
Për të jetuar në diell, re për ta nderuar jetën
Për ta mbajtur fjalën e dhënë
Për ty gjaku nga zemra
Ishte pikë shiu në oqean
O Ruzhdi Berisha
Vallja luhet në çdo drejtim
Me emrin tënd
Edhe mishi piqet në hell të erës
Me emrin tënd

3.
E ke dashur edhe ndonjë kalë
Që i ke hapur derën një kohë të gjatë
Por kur ra nata bërtite
Më lini vetëm
Ata që s'dinë të vallëzojnë
Të mos e prishin ritmin
Në fshehtësi – natën vonë bëre portretin e perspektivës

4.
Ruzhdi nga të gjitha mendimet na mbeti miqësia
Gjaku yt – çlodhje në vuajtje
Kur ti do të vish
Labirinti i zbrazësisë ka rënë
Në gjakun tënd – kullë e dritës
Dhe prapë jeton prore si ngadhënjimtar
I këngës së ngulmimit në kështjellën e të varfërve

5.
Ruzhdi
Emri yt – vigjilencë
Lidhje e lirë ndaj neverisë
Ti nuk na ke braktisur
Emri yt – këngë për paqen
Trëndafil i ditëlindjes për nesër

6.
Hijet janë zhveshur profesor
Dhe pyesin – vallë a kam jetuar?
Trokasin në skaj të botës diku
Me të drejtë vetëm për të shikuar

7.
Nuk mund ta prek askush
Fundin e dashurisë sate
Edhe optimistët e vegjël të përmendin ndonjëherë
Dhe pyesin: a ishte ky dielli

8.
Ti i munde të gjithë profesor
Nga largësitë – e vërteta të bën të lirë
Dhe çuditesh nganjëherë se si mund të kthehej demi në zog
Dëshira pa dashuri – shenjë e mbarimit të botës
Emri yt – shkëmb i urës së diellit
Që shkriu borën e dimrit të çmendur
Vetëm arti i vdekjes i kupton të çmendurit

9.
Gjaku yt – kthim në lumturi:
Lamtumirë e fjalës së paparë
Gjaku yt – epope,
Dëshmitar i vetëm i kështjellës së hekurt

SAMIDIN EMINI

SAMIDIN EMINI

1.
Koha u vonua me ty Samidin
Reklamë mërgimi i bëri
Hijes së trëndafilit
Ringjallja është rruga pa shtëpi Samidin
E ti lajmërove kohën e ujkut
Të gjetur në borë
Mbrëmjeve lajmëroje ankesat e mollës së kopshtit
Lartësia e reve – emrit tënd i dha pamje të dyfishtë për të ankuarit

2.
Samidin
Dëgjova se po flitet për emrin tënd
Edhe aty ku është akull
Gjaku yt – i thur lavdet largësisë
Fill i dritës së diellit
Dikush i numëron orët me emrin tënd
Me qelës jo të njëjtë vizaton zemrat
E gjurmëve të kafshimit
Vdekja për ty qe – kokërr rëre
Mbrëmjeve dëgjohet kënga e zogut
Për botën e stërkequr

3.
Samidin
Dikush asgjë ende nuk di për pemët
As për rrugën e rëndësishme që trazohej
Fjali të thjeshta thurin për vete – me pamje të dyfishtë
E një ditë dikush do të pyes pse
Shtrëngatë vetëtimash e rrufesh shkarkohen
Nëse nuk nderohen pëllumbat e paqes

4.
Samidin
Emri yt rrëke për këngën e dashurisë së atdheut
Në dimër dikush të kërkoi para derës
Me perde të kaltër
E Ti durove
O çatindreqës
Ata që me vete bartnin truallin me tren
Dhe u bënë përrallë e pritjes

5.
Kur përmendet emri yt
Toka dridhet ende
Gjaku yt – dritë – shkëlqim
Në stacionet e natës
Rruazat e gjakut bëjnë betejë
Me mullinjtë e erës
Lotët e harrimit mbetën kundërprovë pas korrekturës

6.
Samidin
Nuk je më në arrati
Ti i di vëzhguesit e gënjeshtrës
Ti je pëllumbi i dërguar
Për të shikuar në qiell
Samidin trimi bërtet
Mjaft nga kjo rrugë e gabuar
Sa e shtrenjtë është rruga e kthimit në atdhe

7.
Kur vjen mëngjesi
Duhet të flasim me njeri tjetrin
Pa dhëmb të zezë
Ta bëjmë bukën për orën e madhe

YMRIDIN ÇENGAJ

YMRIDIN ÇENGAJ

1.
Ishe lodhur e trishtuar nga Satanai
Ndërgjegjja nuk të la të jetosh me të kaluarën
Braktisja e dollisë për këngën e fundit
Për ty vërtetë nuk kish kuptim
U dashurove në përtëritjen e shpirtit
Nuk i doje këngët enigmë
Se krenaria për ty i kish rrënjët
Te dashuria ndaj atdheut

2.
Shtegtari i përhershëm i origjinës
Kontrabandistëve në takim të fundit
Hijen e tymit ua preve
Flutur mes gjithësisë
Që doje atdhe të vetëm
Të mos vdesin yjet mbi dëborë

3.
Nga bregu i amshimit
Thirr frymëzimin e miqve në sytë e tu
Takim të fundit me armikun e vjetër
Ja kryqëzove tmerrin në shtëpinë e braktisur
Në amshim shkove me mikun e vjetër
Me arratinë e fjalëve të panjohura

4.
Ymridin
Vitet po kalojnë
E ne sa herë të kujtojmë
Nisemi nga fillimi- se mashtruesi nuk fle
Nuk do t'i lëmë asnjë minutë qetësi
Shpresave të thyera mes lodhjes e mërzisë
E yjet nuk i mbyllin qerpikët
Për ëndrrat e patreguara

5.
Sa herë lind dielli
U shohim juve Ymridinin dhe marrim frymëzim
Të mos largohemi nga jeta
Fitorja juaj në fushëbetejë
Është dhunti e mundimshme e bijve të tokës

6.
Ata që të harrojnë Ymridin
Do ta shohin ëndërr hijen e vet
Praktikojeni jetën me bisha të egra
Me ecjen tënde nga dielli
Shpresa nuk na le në peshën e mjerimit tonë

7.
Ymridin
Më duket sërish ma bën me kokë
Se nuk i braktis ata që s'bërtasin as që s'vajtojnë
Ata që nuk e luajnë lojën e bushtrës së egër
Zgjohuni sa më herët
Të dashuroni atdheun si dashurinë e parë
Pa britma, me durim e qetësi
Jeta e shthurjes vyshket pa kthim
Pendimi për ta – ngushëllim i vetëm mbeti

8.
Në kupën e pikëllimit rrugët janë të zëna
Doni malet, mikun e njeriun
Ju nuk e dini miq s'kam ftuar
Në netët e dimrit
Të mos zhyten në gjumin e mëngjesit
Dhe e shkrive akullin në xham dhe e solle pranverën

9.
E të gozhduarit gjakun nuk e kujtojnë
As në kafene nuk dëgjohet kambana
E ti do të vish t'i shohësh tregtarët
Si i bëjnë monument vetes
Në lamtumirën e rinisë
Sa herë të nderojmë Ymridin
Kërkojmë veten në thelb të dashurisë

10.
Ymridin
Ëndërr e përditshme
Me ermin tënd i bëjmë nderim njeriut
Për nderin e tokës gjatë shekujve
Enigma e mashtruesve me pallto
Të mos mashtrojë rojet e paqes
Të mos mungojë përgjigja kur mbretërit gënjejnë
Se na qenkan banorë të një planeti tjetër

TASIM KRASNIQI

TASIM KRASNIQI

(Ushtari i UÇK-së, që vdiq tri javë pas lufte, si pasojë e luftës)

1.
Nevoja për jetën
Të bëri ta dashurosh lumin
Ç'na thua për lirinë
Rreth mesnatës me ty
Pushuan të drejtat e një tufe reshë
Ta kam thënë Tasim
E përjetshmja bëhet nga burrëria
Për të jetuar këtu me buzëqeshjen e vrarë

2.
Atë ditë u turbullua komunikimi në kokën tonë
Edhe kur të flemë
Shtëpia e braktisur mendon për zjarrin
Ku me gojën e një të gjalli
Shihet pasqyra për të vërtetën

3.
Askush në botë nuk i beson gënjeshtrës
Që thur vargje për paqen
E unë do ti them të gjitha
Për drejtësinë e mirë
U thyen grilat
Të jetojmë me dëshirën e plotësuar

4.
Ti e di fjalën e keqe për lirinë
Që të mos jemi të vetmuar
Duhet që të mos bëhemi egërsira pylli
Përjashta sonte të ndoqi nata e fundit
Reflekse të bukura bëre në male
Në hijen e derës sate
Sytë tu përherë të pastër

5.
E përkohshme është jeta
Sytë tu ndalën orën e zjarrit të lig
Në shtëpinë e vjetër
Rrezja e artë këndon melodi të lehtë
Dhe tregon se edhe fitimtarët vdesin një ditë

6.
Atë natë u ndal ora
Agimi u nguros në zjarrin e heshtur
Dhe së shpejti vështrove njerëzit
Për fitore në ditët tona

7.
Ti vazhdon të shkruash
Për shqetësimin e njerëzve
Me madhështinë e shpresës
Ti ende zemrën e ke në male me shkrepa
Armiqve të fushës ua prishe folenë
Nata të zuri rrugës

8.
Kur bari ishte korrur
Para ndarjes
The se do të vish sërish
Për të thurur ode
Për dhembjen e lindjes së vështirë

9.
Duke kujtuar të keqen e luftuar
Ti u grinde me vdekjen
Dhe luajte padrejtësisht
Artin e valles së territ
Në shkreptimën e rrufesë

Në vend të epilogut

1.
Që të mos humbej rruga e dritës
Ju Miqtë gurthyes
Trokitet në mullirin e vjetër me ujë
Ku pamjet e tmerrshme
Të Njerëzve me sy nxjerrë
Këndonin Elegjinë e vuajtjes

2.
Ju jeni skulptorët e lirisë
Përmes pyllit fluturuat drejtë dritës
Ku hiri i ftohtë në gurin e nxehtë
Tregoi platformën e vuajtjes së atdheut
Fshehurazi zbritet si muzgu mbi liqe
Lundra juaj përherë roje për ditën e zezë

3.
Ata që flenë mbi përralla të përgjakura
Këndojnë pas luftës
Duke mos vuajtur pas gjithçkaje
Dhe tregoni se si Lufta është këngë e pranverës
Për Endacakët sikur ti derdhnin tërë lotët e krokodilit
Lumi i kaltër nuk ka frikë
Nga shekujt e gurtë që i bëjnë doganë
Shkollës së vdekjes
Të mos ketë ndarje kur këndon kitara
Të mos thyhet shtamba nga zgjedhja e vështirë

4.
Ju treguat se Mjegulla e Dielli nuk janë njësoj
Rrota e mullirit të mos sillet nga të panjohurit
Mbrëmjeve dimërore të kujtohet rënia e gjetheve
Kur jeni Ju
Nuk është e mundur të lotojë zemra ime
Në mërzinë e pafund

5.
Një ditë nëse kthehet gruaja e pabesë
Shuhen orët e shpresës
Bie borë mbi qetësinë e detit
E ju shtegtarë përherë vraponi me shpirt fëmije
Dhe porosisni Mos harroni gëzimin e dhembjes

6.
Më fal dhembje e zemrës së pastër
Për ditëlindjen time – nuk dua këngë djepi
Se fjalën e kanë të rinjtë e përjetshëm
Që i dinë varret e mëkatit për të çmendurit

7.
Me Ju pranvera nuk ik
Me ngrohtësi të madhe – ylberi nuk vdes
Në fushat pas shiut
Shkruani trishtimin e dashurisë

8.
Ju nuk jeni qytet i gurtë
Por ujëra që rrjedhin te burimi
Dhe gjejnë prehje në agimin e puthjes mbi varr

9.
Ju Lule
Ëndrra e gjerdanit të lotëve
Lum lulesh kundër smirës mbetët

Shënime për autorin

Bedri Halimi u lind më 5.03.1963 në fshatin Kuk të trevës së Opojës (komuna e Sharrit). Gjashtë vite të shkollës fillore i kreu në vendlindje, kurse dy të fundit në Bresanë. Shkollën e mesme e filloi në Prizren në drejtimin e biologjisë, ku në vitin e katërt të gjimnazit të atëhershëm "J.R.Kica" u burgos dhe u dënua me disa vite burg, të cilat i mbajti në burgjet e: Prizrenit, Pejës, Zagrebit, Gospiqit, Pulës, Riekës dhe Goliotokut. Pas burgut, disa vite nuk u pranua askund në shkollë, ku pastaj më 1986 arriti ta kryejë në Prishtinë shkollën e mesme drejtimi i Ekonomisë. Studioi blegtorinë në fakultetin e Bujqësisë. Ka zhvilluar edhe një varg aktivitetesh tjera si kryetar i KMDLNJ-së për komunën e Sharrit (një kohë ishte edhe anëtar i redaksisë së Buletinit të KMDLNJ-së në nivelin qendror, koordinator i këshillit të Pajtimit të gjaqeve për komunë e Sharrit.
Më 1997 si pasojë e arrestimeve të shumta të pjesëtarëve të UÇK-së burgoset dhe torturohet rëndë, ku pastaj për një kohë të gjatë qëndron në spital. Edhe përkundër kësaj, gjatë luftës sërish vazhdoi veprimtarinë në radhët e UÇK-së.
Ka shkruar punime të shumta kulturore, letrare e shkencore, në revista të ndryshme në hapësirat shqiptare. Gjatë okupimit ka shkruar shpesh me pseudonime të ndryshme. Shkruan pothuaj në të gjitha zhanret për të rritur si dhe për fëmijë.
Deri tani ka botuar disa libra letrare, publicistike e shkencore si:

1. Ditar Dardanie (poezi për të rritur) 1992
2. Plagë Shpirti (poezi për të rritur) 1995
3. Cubat fshehin Hënën (poezi për të rritur) 1999
4. Rugova - Ngritja dhe rënia (libër publicistik) 2000
5. Kafshët e botës sime (poezi për fëmijë) 2001
6. Qëndresa kombëtare në Opojë dhe dëshmorët e saj (libër historik) 2002
7. Përgatiti për botim librin "Haxhi Ymer Prizreni" 2006
8. Pemët, perimet dhe drithrat në mjekësinë popullore (libër shkencor) 2009

Që nga viti 1991 drejton dhe boton revistën Sharri (revistë informativo – kulturore, artistike e shkencore opojane). Ka bashkëpunuar me të gjitha gazetat, kurse në gazetën Infopress si redaktor, në agjencinë e lajmeve KosovaPress si kryeredaktor. Aktualisht është zyrtar i lartë në Qeverinë e Kosovës (në MMPH, si Kryeinspektor).

Përmbajtja

Ymer Prizreni…7
Baladë e pakryer …15
Kënga e Lumit
Në vend të prologut … 19
Alajdin Xhezairi …23
Abdurrahman Gërdellaj …31
Adem Bereisha …37
Fetah Sylejmani …43
Fisnik Ibrahimi …49
Ilmi Bahtijari …55
Ruzhdi Berisha …61
Samidin Emini …67
Ymridin Çengaj...73
Tasim Krasniqi ...79
Në vend të epilogut ...81

Bedri Halimi
KËNGA E LUMIT

Shtypshkronja
Formati 130 * 200

Sponsor:
Data GIS Consulting

Katalogjizimi